



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Raport për Tremujorin e Dytë 2019

Oda e Mjekëve të Kosovës



Korrik 2019

Prishtinë

Përmbajtja:

Raport për Tremujorin e Dytë 2019	1
1. Anëtarësimi	3
2. Mbikëqyrja etiko-profesionale	4
3. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	6
4. Licencimet	6
5. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për OPSH-të	7
6. Raporti financiar	7
6.1 Gjendja financiare – 30qershor2019	7
6.2 Prokurimi	7
7. Këshilli Drejtues	8
8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së	9
9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së:	9
10. Aktivitete të tjera	9
10.1 Shërbimi profesional	9
10.2 Faksimilet (Vulat)	9
10.3 Bashkë-organizimi i Simpoziumit të parë Mbarëshqiptar të Kirurgjisë Pediatrike	9
10.4 Kongresi dhe Panairi i Parë i Mjekësisë	10
10.5 Marrëveshjet	10
10.6 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	11
10.7 Marrëdhënie ndërkombëtare	11
11. Plani i veprimit për 2019	12
10.1 Projektet afatgjata	12
10.2 Aktivitetet kyçe për T3/2019	12

1. Anëtarësimi

- Gjatë periudhës prill-qershor 2019, në OMK u anëtarësuan 244 mjek, ku 227 janë mjek vendas (duke përfshirë këtu edhe 83 mjekë pa punë dhe 6 mjekë në pension) dhe 17 janë mjekë të huaj.




Tabela 1.1: Anëtarësime për periudhën prill-qershor 2019




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri me datën 30.06.2019

Sfidat:

Nga 4083 mjekë anëtarë të OMK-së prej tyre 3029 të deklaruar se punojnë në ndonjërin nga Institucionet publike shëndetësore, përmes sistemit të listës së pagave nga Ministria e Financave, pagesa për anëtarësi është ekzekutuar për 2743 mjekë dhe atë përgjatë muajve Mars, Prill, Maj.

Përderisa, për 642 anëtarë të cilët nuk e kanë kryer pagesën për kuotën e anëtarësisë nga sektori publik dhe ai privat, ju është bërë njoftimi individual me e-mail dhe me SMS (për ata të cilët nuk kanë pasur e-mail) përgjatë muajit Maj dhe Qershor që të kryejnë pagesën më së largu deri me datën 1 korrik 2019, pas të cilit afat do zbatohen sanksionet bazuar në Nenin 15, Paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Statutit të Odës së Mjekëve të Kosovës, sipas të cilit mos-ekzekutimi i pagesës së anëtarësisë në vazhdimësi prej gjashtë muajve bëhet ndërprerja e anëtarësisë.

Vlen të theksohet se pas gjitha njoftimeve publike zyrtare dhe njoftimeve individuale me datë 1 korrik 2019, 214 mjekë anëtarë nuk kanë realizuar pagesën për kuotën e anëtarësisë dhe rrjedhimisht për këtë numër të mjekëve Komisioni për Licencim pranë OMK-së do të ndërmarrë masat konform akteve juridike në fuqi.

2. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të Odës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën T2	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën T2	Sanksionet e shqiptuara për periudhën T2	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën T2	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Prokurori i Odës	5	11	/////	/////	11
Këshilli i etik	11	9	3 - Gjobë: gjithsej 4500 € 1 Fshirje nga regjistrimi i anëtarësisë për 1 vit Rekomandim kolegjal - 1 Qortime publike -3 1100 € shpenzime	/////	6

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën T2	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën T2	Sanksionet e shqiptuara për periudhën T2	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën T2	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake
			paushallë të procedurës		
Gjyqi i Nderit	2	1	Sipas ankesës është vërtetuar vendimi i Këshillit Etik: Gjobë 3,500€ Qortim Publik 700 € shpenzime paushallë të procedurës	Rekomandim kolegjal: Deklarata e noterizuar – deponuar nga i sanksionuari	2
Certifikatat e të kaluarës etike	36	36	////	////	////

Në shqyrtime të drejtpërdrejta, janë mbajtur gjithsej 2 seanca të shqyrtimit kryesor, në të cilin është mundësuar përfaqësimi i drejtpërdrejtë i palëve në procedurë, përfshirë të drejtën në përfaqësues me autorizim (prokurë).

Sfidat e organeve të OMK-së gjatë ushtrimit të funksionit të mbikëqyrjes etike:


Ndonëse procedurat disiplinore që janë në funksion të mbikëqyrjes etike dhe profesionale, organet e Odës përgjithësisht ballafaqohen me problemet të natyrave si më poshtë:

- Krijimi dhe unifikimi i praktikës procedurale;
- Zhvillimi i koordinimit mes institucioneve publike dhe organeve të Odës;
- Fenomenologjia e trajtimit të rasteve në raport me përvojën e përgjithshme institucionale të Republikës së Kosovës, si procedurë e zbatuar në praktikë së voni; dhe
- Nevoja për njohjen me praktikat ndërkombëtare lidhur me shqyrtimet etiko-profesionale.

Më vete mbetet sfida e kontrollit gjyqësor, pasi që vendimet e organeve disiplinore të Odës që marrin formën e prerë, mund të sfidohen pranë sistemit gjyqësor në procedurë të konfliktit administrativ, përmes paraqitjes së padisë në gjykatë sipas kompetencës lëndore. Ndonëse parashtrimi i padisë nuk e pezullon ekzekutimin e masës disiplinore të shqiptuar sipas vendimit të formës së prerë.


3. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë tremujorit të parë të këtij viti, ka akredituar 41 aktivitete.



4. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim gjatë tremujorit e dytë të vitit 2019, ka lëshuar licenca me kategoritë si në grafikun më poshtë:



Nga data e bartjes së kompetencës për licencim, ky Komision i ka lëshuar gjithsej 1210 licenca.

Komisioni për Licencim i OMK-së bazuar në Rregulloren për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e mjekëve, saktësisht Nenin 14, paragrafi 1 dhe 2, në tremujorin e dytë të 2019 ka shqiptuar gjithsej njëqind e tridhjetë (130) gjopa ndëshkuese për vonesë në anëtarësim prej të cilave:

- a) Nëntë (9) gjopa në vlerë prej gjashtëdhjetë euro (60 €)
- b) Njëzet e tre (23) gjopa në vlerë prej nëntëdhjetë euro (90€)
- c) Gjashtëdhjetë e tetë (68) gjopa në vlerë prej njëqind e njëzet euro (120€), dhe
- d) Tridhjetë (30) gjopa në vlerë prej njëqind e pesëdhjetë euro (150€).

5. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për OPSH-të

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA për shkollim specialistik.

6. Raporti financiar

6.1 Gjendja financiare – 30qershor2019

1.0 Të hyrat:	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2
1.1 Të hyrat e shtyra nga 2018	€143,132.50	
Të hyrat e shtyra nga 2018	€143,132.50	
1.1 Të hyrat nga TM1		
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:		
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€245,993.88	€62,056.86
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jokosovarë	€9,750.00	€4,500.00
1.1.4 Licensimi	€11,367.65	€10,080.00
1.1.5 Të hyrat e tjera*	€23,194.52	€21,358.00
Të hyrat nga TM	€290,306.05	€97,994.86
Të hyrat e shtyra nga 2018		€143,132.50
GJITHSEJ TË HYRAT		€531,433.41
2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2
2.1 Paga dhe kontributet pensionale	€18,199.83	€23,380.10
2.2 Mëditjet	€14,260.90	€11,558.74
2.3 Material shpenzues	€1,344.41	€659.75
2.4 Reprerentacioni	€234.21	€258.80
2.5 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€5,473.25	€8,448.18
2.6 Shpenzimet e tjera*	€35,993.22	€20,246.31
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€3,000.00	€0.00
GJITHSEJ SHPENZIMET	€78,505.82	€64,551.88
GJITHSEJ SHPENZIMET		€143,057.70

GJITHSEJ BILANCI	€388,375.71
-------------------------	--------------------

1.1.5* Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Faksimil, Faksimili i dytë, Kongreset, simpoziumet, seminarët, konferenca vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitetet e organizuara nga kompanitë farmaceutike, Certifikatës për të kaluarën etike, Lejimi për hulumtime bio-mjekësore për anëtarë të Odës, Të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), Dhuratat / donacione, Të ardhurat të tjera

2.6 *Faksimil, Anëtarësimi në CPME, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të TI-së, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Inventari, Shpenzimet e tjera operative.

6.2 Prokurimi

Gjatë tremujorit e dytë të këtij viti u zhvillua një procedurë e negociuar e prokurimit për auditimin funksional dhe financiar për vitin 2018 ku është

arrit marrëveshja me Operatorin Ekonomik “Audit & Conto” NSH dhe vlera e kontratës është 2,400.00 Euro.

Gjithashtu, në muajin Qershor, bazuar në ofertat të pranuar, është bërë furnizimi i zyrave të OMK-së me pajisje kondicioner.

7. Këshilli Drejtues

Në periudhën kohore prill – qershor 2019, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur tre (3) takime, ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën T2	Vendimet sipas kërkesave/ankesave të pranuar për periudhën T2	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën T2	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	29	18	12	<p>1- Për hyrjen në fuqi të përdorimit obligativ të faksimileve (vulave)</p> <p>2- Për programim të pagesës së anëtarësisë në katër (4) këste për mjekët e pa punë</p> <p>3- Formimi I komisionit për pesë (5) punimet shkencore</p> <p>4- Lidhur me taksën administrative për certifikatat e të kaluarës etike dhe profesionale</p> <p>5- Për pezullimin e zbatimit të taksës administrative për inicim të procedurës disiplinore ndaj mjekëve</p> <p>6- Lejimi i stafit akademik të Fakultetit të Mjekësisë, përdorimin e faksimilit të deritanishëm sipas kritereve të përcaktuara nga KD</p> <p>7- Për publikimin e konkursit publik (punimet shkencore)</p> <p>8- Formimi i komisionit Ad-Hoc për negociata me kompaninë e auditimit “Audit&Conto”</p>	1

8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Në periudhën kohore prill – qershor 2019, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar dhe ka shqyrtuar dy (2) kërkesa për leje hulumtimi. Të dy (2) kërkesat e shqyrtuara janë aprovuar nga Komisioni për Çështje Etike dhe aplikantëve i është lëshuar leja për hulumtim.

Gjithashtu Komisioni gjatë kësaj periudhe, përveç vendimeve për leje-hulumtime, Komisioni për Çështje Etike, ka nxjerrë edhe vendimin ku janë miratuar kriteret për leje-hulumtimet bio-mjekësore në njerëz.

9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së:

Në periudhën kohore prill – qershor 2019, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar një kërkesë për përkrahje financiare për të cilën është nxjerrë Vendim për refuzim të mbështetjes financiare.

10. Aktivitete të tjera

10.1 Shërbimi profesional

Me datën 25 prill 2019, është bërë përzgjedhja për 3 kandidat të suksesshëm për pozitën Asistent Administrativë pranë Komisioneve përhershme sipas konkursit të publik të datës 23.03.2019.

10.2 Faksimilet (Vulat)

- Gjatë periudhës prill-qershor 2019, Oda e Mjekëve të Kosovës, ka përgatitur 804 faksimile. Numri total i faksimileve të përgatitur deri me datën 30 qershor 2019 është 4060 dhe përfshin të gjithë anëtarët e OMK-së të kualifikuar për t'u pajisur me faksimil (anëtarë me licencë valide).
- Me datën 1 maj 2019, ka hyrë në fuqi Vendimi për përdorimin Obligativ të vulave (faksimileve) të autorizuara dhe prodhuara nga OMK për të gjithë anëtarët e Odës. Sipas vendimit, çdo përdorim i vulave të tjera të prodhuara apo punuara individualisht dhe të përdorura nga anëtarët e OMK-së apo mjekë ende të pa anëtarësuar është në kundërshtim me këtë vendim si dhe në kundërshtim me aktet tjera juridike të OMK-së, është vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Bazuar në këtë vendim, një rast është në procedurë të Këshilli Etik të OMK-së.

10.3 Bashkë-organizimi i Simpoziumit të parë Mbarëshqiptar të Kirurgjisë Pediatrike

- Më 19 prill 2019, nën patronazhin e Odës së Mjekëve të Kosovës dhe në bashkë-organizim me Klinikën e Kirurgjisë Pediatrike është mbajtur Simpoziumi i Parë mbarëshqiptar i Kirurgjisë Pediatrike.

10.4 Kongresi dhe Panairi i Parë i Mjekësisë

Kongresi dhe Panairi i Parë Mjekësor do të mbahet me 18-19 tetor 2019, në Hotel Emerald në Prishtinë. Në këtë aktivitet pritet të ketë deri në 2000 pjesëmarrës, dhe përveç ligjëratave gjatë kongresit gjithashtu do të organizohen tre Punëtori me temat:

- Menaxhimi i avancuar i rrugëve ajrore/Menaxhimi i rrugëve ajrore ne trauma
- Diagnostika e avancuar në pacemaker dhe ICD
- Trombektomia mekanike- Standardi i artë për iskemine akute cerebrale (AIS), përvoja klinike

Këshilli Shkencor ka përcaktuar kriteret për dërgimin e abstrakteve të punimeve shkencore. Aplikimi dhe dërgimi i abstrakteve ka filluar më 1 Qershor.

Është bërë hapja e afatit për aplikim për sponsorizim të Kongresit dhe ekspozim në Panair, ku kompani të ndryshme për pajisje dhe produkte medicinale, farmaceutike dhe dentare kanë shprehur interesim për të qenë pjesë e Panairit.

Gjithashtu është hapur një faqe e veçantë për Kongresin dhe regjistrimin e pjesëmarrësve

10.5 Marrëveshjet

- ***Memorandum bashkëpunimi me Inspektoratin Shëndetësor***

Me 2 prill 2019, është nënshkruar memorandum i bashkëpunimit në mes të Odës së Mjekëve të Kosovës dhe Inspektoratit Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është zyrtarizimi i bashkëpunimit të ndërsjellë institucional për të siguruar një mbikëqyrje dhe zbatim të legjislacionit në fuqi, sigurimin e integritetit profesional të mjekut si profesionist shëndetësor, forcimin institucional të sistemit shëndetësor në interes të përgjithshëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës duke mbrojtur kështu edhe interesat e pacientëve që janë përfitues të shërbimeve shëndetësore.

- ***Memorandum me Odën e Stomatologëve të Kosovës***

Oda e Mjekëve të Kosovës dhe Oda e Stomatologëve të Kosovës në muajin Maj kanë lidhur Memorandum bashkëpunimi, duke e konsideruar të domosdoshëm këtë bashkëpunim për rritjen dhe përmirësimin e standardeve dhe cilësisë së kujdesit shëndetësor.

Odat u dakorduan për t'i njohur disa nga format e ndryshme të organizimit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional në mënyrë reciproke me anë të akreditimit

• **Memorandum me Sigal UNIQA Group Austria**

Oda e Mjekëve të Kosovës dhe Kompania e Sigurimeve Sigal UNIQA Group Austria në muajin Qershor kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi. Ky memorandum synon komunikim në mes subjekteve të memorandumit lidhur me ofrimin e sigurimit të përgjegjësive profesionale për mjekët/anëtarë të OMK-së nga kompania e sigurimeve.

Oferta është dizajnuar për përgjegjësinë profesionale të mjekëve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre të cilët mund të atakohen me rreziqe të ndryshme, ndër më të rëndësishmit ato të gabimeve të mundshme profesionale, ku këto gabime mund ti bëjnë përgjegjës ligjërisht ndaj palëve të treta.

10.6 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional lidhur me veprimtarin profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OSh-të, në bazë të kërkesave nga Gjykatat dhe prokurorit publike të Kosovës, ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësive profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës. Ekspertiza të tilla kanë qenë në shërbim të konstatimit të përgjegjësive individuale të mjekëve të cilët i janë nënshtruar procedurave penale apo dhe civile, qoftë në fazën hetimore apo gjatë shqyrtimeve gjyqësore.

Ekspertizat:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën T2	Vendimet sipas urdhëresave të pranuar për periudhën T2	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën T2	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Kryetari i Odës	3	4	///	1	1

10.7 Marrëdhënie ndërkombëtare

• **Kongresi i 122-të të Odës së Mjekëve të Gjermanisë:** Oda e Mjekëve të Kosovës, përfaqësuar nga Nënkryetari i OMK-së Dr. Rrezart

Halili, në muajin maj të këtij viti ka marr pjesë në Kongresin e 122-të të Odës së Mjekëve të Gjermanisë.

- **Komiteti i Përhershëm Evropian të Mjekëve (CPME):** Oda e Mjekëve të Kosovës, ka marr pjesë në punimet e takimit të radhës së Komitetit të Përhershëm Evropian të Mjekëve (CPME), pjesëmarrja e parë kjo pas anëtarësimit të OMK-së në këtë institucion ndërkombëtar.

11. Plani i veprimit për 2019

10.1 Projektet afatgjata

- Projekti për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të, mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha ato, dhe më pas është dorëzuar në MSH. Fillimi i ndërtimit pritet të fillon brenda vitit 2019.
- Është miratuar kërkesa nga OMK drejtuar LuxDev-it përmes Ministrisë Shëndetësisë lidhur me përkrahje financiare për zhvillimin e sistemit informativ/databazë interaktive, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Projekti është në fazën e identifikimit të specifikacioneve.

10.2 Aktivitetet kyçe për T3/2019

- Zbërthimi i kompetencave për edukimin specialistik bazuar në ligjin për OPSH-të;
- Konferenca dhe Panairi i Parë i Shkencave Mjekësore (Këshilli Organizativ është emëruar dhe organizimi ka filluar tanimë)
- Përfundimi i auditimit financiar dhe funksional